



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 317/1 prot.



Nr. 3006/1 Prot
Dt. 08.05.2024



Shkodër, më 08.05.2024

Lënda: Mbi Vendimin nr. 31, datë 29.04.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, neni 37, pika 1, shkronja “c”, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “gj”, neni 41, pika 2, të VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3.1, shkronja “a”, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, të shkresës së AKMC nr. 446/2 prot., datë 20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 3002 prot., datë 03.05.2024 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 29.04.2024”, shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 31, datë 29.04.2024 “Mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”*, me ndihmë financiare 9 shtetasve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, në shumën prej 2 499 367 lekë, me burim financimi nga fondet e kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për vitin 2024 për Bashkinë Vau Dejës në masën 2 500 000 lekë.


Kjo vendimarrje është në vijim të VKB Vau Dejës nr. 8, datë 12.02.2020, të VKB Vau Dejës nr. 74, datë 28.10.2022, të VKB Vau Dejës nr. 72, datë 29.09.2023, për dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 31 datë 29.04.2024

Mbi

“Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtura nga tërmeti i dt.26.11.2019”

Bazueshmëria ligjore e vendimit është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar ,Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”,Vendimi Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, si dhe në shkresën nr.446/2 dt.20.02.2024 të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.1247 Prot dt.22.02.2024 si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 91 dt.21.12.2023 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2024”, i konfirmuar nga Prefektura me shkresën Nr.2/1 dt.09.01.2024, Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej 2.499.367 (dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë në masën 15% të vlerës së dëmit për 9 (nëntë) shtetasit e Bashkisë Vau-Dejës të dëmtuar nga tërmeti i dt.26.11.2019 në totalin e vlerës së mbetur të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tyre sipas listës bashkëngjitur:
2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.
3. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Mbrojtja Civile “i cili është miratuar në rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile për vitin 2024, ” që është bërë i disponueshëm në Sistemin Informatik financiar të Qeverisë sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3806/1 dt.29.03.2024,
4. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar).

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Ervis Shimagj

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 23.05.2024



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Andrija Çelepyze



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Projekt Vendimi Nr.1

Dt.16.04.2024

Mbi

Perfundimin e dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i 26.11.2019

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ,Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njezore”,VKM Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile i ndryshuar ,si dhe në shkresën e AKMC Nr.446/2 prot dt.20.02.2024 ”Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024”,e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.1247 dt.22.02.2024, si dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.91 dt.21.12.2023 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2024 “konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën Nr.2/1 dt.09.01.2024”,

Përsa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga tërmeti i rënë me 26.11.2019 në banesat e tyre që janë banorë të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:


V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiarë të menjëhershme me shumën 2.499.367 (dymilion e katërqind e nentdhjete e nente mijë e treqind e gjashtedhjete e shtate lekë në masën 15% te vlerës totale të dëmit për 9(nëntë) familjet e dëmtuara nga tërmeti i dt.26.11.2019 për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre sipas listës bashkëngjitur për të mbuluar 50 % të vlerës totale të dëmit të shkaktuar në banesat e tyre.
2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorëve të dëmtuar.

3. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Mbrojtja Civile “i cili është miratuar në rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile për vitin 2024” që është bërë i disponueshëm në Sistemin Informatik financiar të Qeverisë sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3806/1 dt.29.03.2024,

Konfirmoi bazen ligjore

Krishini Shtati



Konceptoi

Valjeta Nikaj



Miratoi

Xhuana Kaçi



KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI



LISTA E FAMILJEVE TË DËMTURA NGA TERMETI I DT.26.11.2019

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Adresa N.J.A.	Adresa sipas qyteti/fshat	Kërkk/ banor data	Nr frymeve	Vl.totale dëmit sipas prevenit/lekë	Trajtuar 35% 2020 & 2021&2023	50%	Diferenca
1	Gjon	Dod	Llesh	Njës Qender	Qyteti Vau-Dejës	10.12.2019	2	1.704.338	592.257	852.169	259.912
2	Anton	Gjon	Pylla	Njës Qender	Lagjia Deje	02.12.2019	1	1.843.682	658.052	921.841	263.789
3	Simon	Luigj	Peci	Njës Qender	Fshati Kaçë	27.11.2019	3	1.544.324	536.651	772.162	235.511
4	Lazer	Hil	Dragusha	Njës Qender	Fshat Shelqet	27.11.2019	2	1.972.607	685.485	986.304	300.819
5	Leze	Zef	Mami	Njës Bushat	Fshati Bushat	11.12.2019	3	1.915.608	665.671	957.804	292.133
6	Vasil	Pjeter	Ismajlaj	Njës Bushat	Fshati Plezhe	27.11.2019	6	1.840.355	639.486	920.178	280.692
7	Paulin	Jak	Hilacukaj	Njës Bushat	Fshati Konaj	02.12.2019	5	1.761.088	611.978	880.544	268.566
8	Gjergj	Pjeter	Plepi	Njës Bushat	Fshati Plezhe	02.12.2019	3	2.411.639	838.049	1.205.820	367.771
9	Petro	Ded	Ndreca	Njës.Vig Mnele	Fshati Mnele e Madhe	05.12.2019	3	1.509.784	524.717	754.892	230.175
Shuma								16.503.425	5.752.346	8.251.713	2.499.367

P/SEKTORIT EMERGJENCAVE CIVILE

Valjet NIKAJ



KRYETARI I BASHKISË
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1/1 Prot.

Vau Dejës, me 16/09 2024

RELACION

Për perfundimin e dhënies ndihmës financiare familjeve
të dëmtuara nga termeti 26.11.2019

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia e re Vau-Dejës ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në pjesën veriore të vendit. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, kryeqyteti i vendit është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e Bashkisë është qyteti i **Vaut të Dejës**.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligjin nr 115/2014 “Për ndarjen administrativo–territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Vau-Dejës, Temal dhe Shllak. Bashkia ka nën administrim 47 fshatra dhe një qytet. Njësia administrative Bushat ka numrin më të lartë të fshatrave (14 fshatra), i cili vijohet nga Temal (10 fshatra). Njësitë administrative Vig Mnelë dhe Hajmel kanë një numër shumë të vogël të fshatrave, respektivisht tre dhe pesë. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Shkodër të Qarkut Shkodër.

Ligji Nr.139/2015 për Vetqeverisjen vendore në nenin 29 thuhet: *Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve: 1. **Mbrojtjen civile**, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

VKM nr.329 dt.16.05.2012”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore pika 1 thuhet: ” *Shteti ndihmon financiarisht të dëmtuarit, në rastet kur , si rezultat i fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore , kanë pësuar dëmë ne njërrëz dhe dëme në materiale në kushtet kur për përballimin e situatës :*

Është shpallur gjendja e emergjencave civile

Nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile

Në Ligjin nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” ,Neni 65 ,thuhet: *Bashkitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësite, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre , të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.*

Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burime financiare si: të ardhurat vendore, nga fondet që ju vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare , huamarrja vendore , donacionet, burime të tjera të parashikuara në ligj.

Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me Vendim të Këshillit Ministrave, që është VKM Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile në pikën 3 thuhet: “Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritizimit sipas pikës 3.1: dhe VKM Nr.290, dt.17.05.2023”Për një ndryshim në VKM Nr.414, dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” në kuader të ushtrimit të detyrave funksionale,

✦ **60-100 % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për a: Akordimin e ndihmës financiare për familjet , banesat e të cilave janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera , sipas kriterëve specifikë të përcaktura në aktet nënligjore që rregullojnë ligjin Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 41.**

Në ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, Neni 41 pika 2 thuhet: “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia , nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile” si dhe pika 3 thuhet: “Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitet pasardhëse , deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.

Gjatë vitit 2019, si pasojë e tërmetit janë demtuar 14 objekte banimi për të cilat është zbatuar procedura në zbatim të VKM Nr.329/2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe janë trajtuar sipas VKB-ve përkatëse 5 prej tyre në masën 50% të vlerës totale të demit, ndërsa 9 familjet e mbetura janë trajtuar gjatë vitit 2020 & 2022 dhe 2023 deri në masën 35% të vlerës së demit.

Në këtë projekt vendim 9(nëntë) familjet e mbetura pa u dëmshpërblyer që janë dëmtuar nga tërmeti me 26.11.2019 parashikojmë të trajtohen në masën 15% të vlerës totale të demit për të mbuluar masën 50% të kompensimit.

Bashkengjitur relacionit është edhe tabela e detajuar me të gjitha të dhënat e nevojshme për argumentimin e fakteve që thamë me sipër .

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit Nr.1 dt.19.04.2024.

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Miratoi

Xhuana Kaçi